

FJALA E DEPUTETIT VANGEL DULE

E ENJTE DATA 2 MARS 2023

E nderuar zonja Kryetare,

Më në fund lideri i madh global denjoi që t'i drejtohet parlamentit. Na begenisi edhe ne me një fjalim programatik të mbështetur në fyerje, të mbështetur në arrogancë dhe në shpërfillje, në këtë mënyrë duke përcjellë të gjitha këto edhe ndaj qytetarit dhe shoqërisë. Diskutojmë një çështje që ka dy anë të medaljes, njëra është në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe tjetra është këtu. Nuk do ta mësonim asnjëherë këtë çështje në qoftë se Amerika nuk do të ishte ajo që është. Më lejoni të perifrazoj një poet shumë të madh, Kavafis, i cili thoshte: “Është bota, është qyteti i ideve dhe në atë qytet është e rrallë dhe e vështirë të përfitosh nënshtetësinë. Në atë qytet ka legjislatorë të zotë, që nuk mund t'i mashtrojë çdo aventurier”. Këto janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ky aventurier është Kryeministri ynë, i pari juaj. Nuk do ta ndihmojmë dot ne procesin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sepse do të shkojë gjithmonë e më thellë, do të jetë i dhimbshëm për të gjithë ata, të cilët identifikohen me liderin global, por ne duhet të shikojmë anën tjetër të medaljes, pra atë që na preokupon. Shumë kolegë u shprehën se Edi Rama nuk foli sot, por Edi Rama foli shumë, Edi Rama nuk u fsheh, Edi Rama foli me zë të lartë. Natyrisht, jo për çështjen “McGonigal”, por foli për vendin tonë dhe për ne. Ai na tha në mënyrë sfiduese thënien luigjiane: “Shteti jam unë. Shtetin e mbaj dhe e administroj në xhepin e xhakëtës sime”. Besoj se e kuptuat! Ishte i qartë në të gjitha pohimet e tij. Ai nuk i jep llogari kujt. Hidhini një sy portalit zyrtar të Shtëpisë së Bardhë, të presidentit francez, të kryeministrit britanik dhe do të shikoni agjendën ditore se kë do të takojë ai nesër, në çfarë ore, në cilin vend do të udhëtojë, pse do të udhëtojë dhe sa do të qëndrojë. Mirë ne të opozitës nuk e dimë, në një kohë që duhej ta dinte i gjithë opinioni, po ju a e dini se ku lëviz lideri juaj global dhe pse lëviz? A është koncept shteti ky?! A janë institucione këto, që funksionojnë në republikë parlamentare dhe meritojnë duartrokitje? A meriton identifikim me këto praktika? Nuk e besoj, por megjithatë ju e bëni. Halli është juaji dhe vetës qarohuni me ata njerëz që ju votojnë, se nuk jeni për një demokraci, nuk jeni për të përfaqësuar alternativa dhe politika, jeni duartrokitës panegjirik të të parit dhe, fatkeqësisht, nuk dëshironi të shikoni se ku po na çon të gjithë. Në fjalën e tij sot kishte vrer dhe helm për këdo që mendon ndryshe, kishte arrogancë për këdo që mendon dhe artikullohet kundër politikave të tij.

Në djepin e kulturës së sotme perëndimore, në Athinë, kanë një koncept, pjesë të pandarë të botëkuptimit në periudhën më lulëzuese të demokracisë, që është sindroma “Hubris”, të cilën kam pasur rastin t'ia përmend përsëri liderit tonë global. Kjo sindromë ka katër faza: e para është “Ibris hubris”, kur arroganca, mbivlerësimi i vetes dhe nënvleftësimi i të tjerëve të çon deri në atë farë mase, që përbën fyerje për ligjin e shkruar dhe për ligjin e pashkruar moral dhe kalon deri në fyerje të hyjnive. Këtu ndërhyjnë hyjnitë për të sjellë fazën tjetër, që është “Atis”, që zullumin e bëjnë më të madh, të përvëlojnë dhe të verbojnë. Pikërisht në këtë fazë është lideri ynë i madh, i cili në turbullirën e kapjes së pushteteve mendon se mund të bëjë gjithçka. Më pas vjen faza “Nemesis”, që ndëshkimi dhe fundi janë shumë afër njëra me tjetrën. Këto momente po i jetojmë, madje me shumë dhimbje dhe me kosto të mëdha, që lihen pas për vendin, shoqërinë dhe qytetarët. Ju jeni kolegë shumë të zotë në atë që keni studiuar dhe në atë që keni lëvruar në jetën tuaj. Gjithashtu, në Grupin Parlamentar të Partisë Socialiste ka juristë shumë të zotë, ndaj ju sugjeroj të lexoni një libër të vitit të shkuar të një ekonomisti rus antiputnist, me emrin Sergei Guriev dhe të një analisti politik amerikan me emrin Daniel Treisman,

i cili titullohet "Spin dictators". Lexojeni me vëmendje dhe nëse në çdo faqe nuk ju del përpara Edi Rama me mënyrën si ju trajton ju, pushtetin, opozitën, parlamentin, qytetarët dhe fatet e vendit, atëherë keni të drejtën ta duartrokisni edhe më fort, të brohorisni për të dhe për bëmat e tij. Si ka mundësi që një koleg shumë i nderuar i opozitës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës i bëri himn sistemit të drejtësisë dhe iu tek kështu kot së koti t'i përmendë emrin 14 herë Kryeministrit të vendit të dytë më të vogël të NATO-s?! Çfarë është një aktpadi, hartim apo ese? Apo pas çdo fjale dhe emri fshihet një argument, një fakt, nëse është gjendur ose është në kërkim? Zonja dhe zotërinj, Asnjë njeri i përgjegjshëm, hijet e aktivitetit të tij, të cilat i faturohen në një moment të caktuar të karrierës politike, nuk mund t'ia faturojë vendit, t'ia faturojë shoqërisë, dhe aq më tepër partisë së tij, që as nuk mund të mendohet. Shikoni çfarë ndodhi në Britaninë e Madhe në një hark kohor shumë të shkurtër, ku 3 ministra të konservatorëve dhanë dorëheqjen për diçka minore, për një party, ndërsa Kryeministrit tonë, të cilit i përmendet emri 14 herë, po kaq herë do të hetohet në vazhdimësi në një aktpadi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ju i jepni një letër faljeje. Kjo është e drejta juaj, por ballafaqohuni me ata që ju përfaqësoni nëse ata ju legjitimojnë në këtë veprim. Faleminderit!